



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA VIII
Sesioni pranveror

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis, Planifikim Hapësinor dhe Infrastrukturë
Mbledhja nr. 14
Prishtinë, më 13.7.2021, në orën 9:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Fitore Pacolli-Dalipi, Milazim Salijaj, Ekrem Mustafa, Arbëreshë Kryeziu- Hyseni, Salih Zyba, Bekim Haxhiu, Samra Ilijazi dhe Albena Reshitaj.

Munguan: Zoran Mojsilović, Fadil Nura dhe Besian Mustafa.

Pjesëmarrës të tjerë: Edolind Bytyçi, praktikant, Valon Dobruna, Florent Mehmeti, Shqipe Shala, Hajriz Berisha, ekspert Mjedisor FES-KUV-KS, Fitim Gashi, ndihmëskëshilltar, GP Vetëvendosje dhe të tjerë sipas listës së nënshkrimeve.

Stafi mbështetës i komisionit: Bajram Badivuku dhe Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi, **Fitore Pacolli-Dalipi, kryetare e komisionit.**

Në këtë mbledhje u propozua ky:

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar më 9.7.2021;
3. Shqyrtimi i Projektligjit nr.08/L-004 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit 05/L-132 për Automjete;
4. Shqyrtimi i Projektligjit në parim nr. 08/L-012 për Odat e Arkitektëve dhe Inxhinierëve në fushën e ndërtimit;
5. Shqyrtimi i Projektligjit në parim nr. 08/L-010 për Krijimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Hapësinor;
6. Shqyrtimi i Projektligjit në parim nr. 08/L-011 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-061 për Shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore;
7. Shqyrtimi i përfshirjes së Ligjit për farërat në agjendën e komisionit për mbikëqyrjen e ligjit;
8. Caktimi i ekspertëve dhe grupeve punuese për mbikëqyrjen e ligjeve;
9. Të ndryshme.

Kryetarja konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Albena Reshitaj sugjeroi njoftimet për mbledhjet e komisionit të janë të afatshme, por jo të ngutshme për shkak se në këtë komision ka deputetë me angazhime edhe në komisione tjera.

Salih Zyba kërkoi të diskutohet në të ndryshme për rastin e helmimeve në Deçan.

Komisioni miratoi rendin e ditës me 7 vota për, asnjë kundër, asnjë abstenim.

2. Miratimi i procesverbalit i mbledhjes së mbajtur më 9.7.2021

Komisioni miratoi procesverbalin me 8 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim.

3. Shqyrtimi i Projektligjit nr.08/L-004 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit 05/L-132 për Automjete

Kryetarja tha se rreth këtij Projektligji kemi diskutuar edhe gjatë leximit të parë dhe kemi marrë vendim që të procedojmë tutje.

Bekim Haxhiu theksoi se është pro heqjes së homologimit për vetura të reja që janë me certifikatë të konformitetit, për liberalizim të sektorit, deri më tani çdo e katërta veturë ka një defekt madhor për t' u kthyer në vendin e origjinës. Janë me mijëra vetura të falsifikuara në kilometra të cilat nuk detektohen përmes kontrolleve teknike, por përmes homologimit dhe është humbje milionëshe për buxhetin e Kosovës duke ditur që bazuar në kilometra caktohet edhe vlera e doganës. Nuk është në rregull që në emër të populizimit me lejuar makina të tilla me hy në Kosovë dhe me rrezikuar jetën e qytetarëve. Ky ligj kështu si është nuk mund të dërgohet në seancë, ngase ligjet nuk mund të miratohen pa dëgjim publik, po ashtu ministri nuk mund që me vendim me lejuar heqjen e homologimit për shtete të caktuara. Ministri nuk mund të ketë autoritet suprem mbi ligjin. Nëse keni dashtë që t' ja bartni të drejtën ministrit për heqje të certifikatës së konformitetit, atëherë nuk është dashtë të jetë pjesë ligjit shtetet e BE-së, Norvegjia dhe Zvicra, por ka mundur të jetë që listën e përcakton ministri. Do të ishte mirë që për këtë çështje të jepnin mendim edhe ekspertët që i ka komisioni.

Albena Reshitaj potencoi se është mirë që po bëhet plotësim - ndryshimi i këtij ligji, homologimi i automjeteve të reja ka qenë gabim, si ish ministre e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor shpreh shqetësimin tim mbi makinat e vjetra, kam qenë dhe do të jem pro kontrollimeve teknike për makinat e vjetra që futen në Republikën e Kosovës, sepse Kosova nuk do të duhej të shihej si një vend i automjeteve të vjetra të gjithë Evropës. Ju e dini që makinat e vjetra kanë probleme të mëdha sa i përket kualitetit të naftës dhe benzinës, dhe më vjen keq që nuk e kam hulumtimin që e pata filluar për verifikimin e kualitetit të derivateve. Jam pro vendimit të Kryeministrit të Republikës së Kosovës që potencon që hiqet homologimi për veturat e reja, ndërsa si ish ministre, për veturat e vjetra mendoj se duhet të ketë një kontroll dhe një kriter që për import të automjeteve të përdorura sipas nenit 44 par.2 i Ligjit Bazik që është standardi Euro 4 (Katër), edhe me rastin e homologimit në import të verifikohet edhe ky kriter teknik.

Kryetarja u pajtua se duhet të ketë një studim se sa janë ndotës veturat në shtetin tonë dhe cilësinë e naftës dhe benzinës, në vitin 2015 në Komunën e Prishtinës kemi gjetur se nafta përmban 800 ppm e që me direktivat e BE-se përmban vetëm 10 ppm, çështjen e ndotjes do ta diskutojmë dhe ta shqyrtojmë mundësin që të futet në ligjin e ri.

Salih Zyba: Në deklaratën e Bekim Haxhiut për media se “çdo e katërta veturë ka një defekt madhor për t' u kthyer në vendin e origjinës” theksoi se nuk ju ke referuar burimit, a është studim i kompanive, ndonjë dikaster, ministria, do të ishte mirë të përcaktojë burimin e informatës. Sa i përket hulumtimeve dhe humbjeve milionëshe të shtetit, kontrolla prapë do të jetë pagesa është

heq, është evidente që pagesa si barrë tarifore për qytetarët, në këtë fazë duhet të vijë nga ministrit përkatëse lirimi nga pagesa në akcizë dhe tarifa të tjera. Jemi duke e hequr një pagesë apo një barrë që nuk e ka ndërmarrë asnjëherë më parë shteti.

Sa i përket asaj se ministrit po i jepet autoritet mbi ligjin, nuk është se ministri mund të bëjë çka të dojë, por një zgjidhje për vendet e caktuara që ato bëhen pjesë e Europës pjesë e standardit fillojnë me prodhues standarde veç për Evropën, shqetësimi se ministri po bëhet monopol nuk ekziston.

Bekim Haxhiu përsëriti se është pro heqjes së homologimit për vetura të reja, ndërsa sa i përket pagesës, ligji flet vetëm për pjesën e homologimit jo edhe për pagesë, sa i përket burimit, informatat i kam marrë në Raportin e Ministrisë së Infrastrukturës. Lista e shteteve të përcaktuara në paragrafin 1.14 mund të ndryshohet ose plotësohet me vendim të ministrit, varësisht nga ndryshimi i standardeve, pra standardet i ka lënë kriter që ministri me vendosur.

Kryetarja ftoi deputetët për votim të raportit me dy amendamente të aspektit teknik:

Amendament 1

Te emri i ligjit, fjala “**NDRYSHIM**” zëvendësohet me “**NDRYSHIMIN DHE**”

Amendament 2

Neni 1, fjalia e parë ndryshohet si vijon: “**Në Nenin 9 të Ligjit bazik, në paragrafin 1 pas nënparagrafit 1.12 shtohen nënparagrafët 1.13 dhe 1.14 si dhe shtohet paragrafi 2, me tekstin si vijon:**”

të cilat do të procedohen komisioneve të përhershme dhe konstatoi se komisioni, me 6 vota për dhe 1 abstenim, vendosi që komisioneve të përhershme t’ua paraqesë Raportin me amendamente për Projektligjin.

4. Shqyrtimi i Projektligjit në parim nr.08/L-012 për Odat e Arkitektëve dhe Inxhinierëve në fushën e ndërtimit

Kryetarja e paraqiti për shqyrtim në parim Projektligjin nr. 08/L-012 për Odat e Arkitektëve dhe Inxhinierëve në fushën e ndërtimit dhe tha se, qëllimi i këtij Projektligji është rregullimi i profesionit të arkitektit dhe inxhinierit në fushën e ndërtimit. Me këtë ligj themelohen Oda e Arkitektëve dhe Oda e Inxhinierëve në Fushën e Ndërtimit si dy Oda të pavarura të cilat ushtrojnë kompetenca të caktuara publike. Ky ligj rregullon anëtarësinë, selinë, statusin, rolin dhe fushëveprimin e odave, profesionet, licencimin, përgjegjësinë disiplinore dhe edukimin e vazhdueshëm të arkitektëve dhe inxhinierëve në fushën e ndërtimit. Ky ligj është pjesërisht në përputhje me Direktivën 2005/36/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit e 7 Shtatorit 2005 mbi njohjen e kualifikimeve profesionale. Departamenti i Buxhetit në Ministrinë e Financave vlerëson se Projektligji nuk do të krijojë kosto shtesë buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës. *Projektligji i plotëson kushtet e parapara në nenin 54 të Rregullores së Kuvendit dhe propozoi që t’i rekomandohet Kuvendit për miratim në parim.*

Pasi që nuk kishte diskutime, kryetarja ftoi deputetët për votim dhe konstatoi se komisioni, me 8 vota për, vendosi që Kuvendit t’ia paraqesë këtë:

Rekomandim

Të miratohet në parim Projektligji nr. 08/L-012 për Odat e Arkitektëve dhe Inxhinierëve në fushën e ndërtimit.

5. Shqyrtimi i Projektligjit në parim nr.08/L-010 për Krijimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Hapësinor

Kryetarja e paraqiti për shqyrtim në parim Projektligjin nr.08/L-010 për Krijimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Hapësinor dhe tha: Informacionet hapësinore janë shumë të rëndësishme dhe të domosdoshme për Republikën e Kosovës. Këto informacione janë të rëndësishme edhe për institucionet e ndryshme ndërkombëtare. Në Republikën e Kosovës shumë institucione krijojnë informacione hapësinore në lëmit për të cilat kanë kompetenca dhe përgjegjësi. Informacionet hapësinore përgatiten në formate të ndryshme që shpesh kanë vështirësi në këmbimin dhe përdorimin e tyre nga institucionet e ndryshme të Kosovës, por edhe atyre ndërkombëtare që punojnë dhe veprojnë në Republikën e Kosovës. Prandaj është shumë e domosdoshme që informacionet kryesore që krijohen nga institucionet e ndryshme të sistemohen në një bazë të të dhënave që do ta përbëjnë Infrastrukturën kombëtare të informacioneve hapësinore për Republikën e Kosovës. Ky Ligj është në përputhshmëri me Traktatin mbi Funksionimin e Bashkimit Evropian dhe Direktivën e Bashkimit Evropian 2007/02 BE të Parlamentit Evropian të dt. 14.03.2007, që përcakton Infrastrukturën e Informacionit Hapësinor në Komunitetin Evropian. Kosto të veçantë nuk do të këtë pasi edhe tani institucionet në Kosovë krijojnë të dhëna hapësinore sipas buxhetit ekzistues. Pas krijimit të Infrastrukturës për Informacione Hapësinore në Republikën e Kosovës, këto të dhëna do të grumbullohen dhe administrohen nga AKK. *Projektligji i plotëson kushtet e parapara në nenin 54 të Rregullores së Kuvendit dhe propozoi që t'i rekomandohet Kuvendit për miratim në parim.*

Pasi që nuk kishte diskutime, kryetarja ftoi deputetët për votim dhe konstatoi se komisioni, me 8 vota për, vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:

Rekomandim

Të miratohet në parim Projektligji nr. 08/L-010 për Krijimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Hapësinor

6. Shqyrtimi i Projektligjit në parim nr.08/L-011 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-061 për Shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore

Kryetarja e paraqiti për shqyrtim në parim Projektligjin dhe tha se me Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligji nr.04/L-061, për Shitjen e Banesave për të cilat Ekziston e Drejta Banesore propozohet që të zgjatet afati për shitjen e këtyre banesave dhe të përfundoj ky proces brenda 3 (tre) viteve, përkatësisht deri në vitin 2023. Departamenti i Buxhetit në Ministrinë e Financave vlerëson se Projektligji nuk do të krijojë kosto shtese buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës. Dispozitat e Projektligjit nuk janë të rregulluara me legjislacion të BE-së dhe si e tillë kjo fushë mbetet në kompetencë të brendshme të shteteve anëtarë të BE-së. *Projektligji i plotëson kushtet e parapara në nenin 54 të Rregullores së Kuvendit dhe propozoi që t'i rekomandohet Kuvendit për miratim në parim.*

Deputeti Salih Zyba kërkoi një historik për këtë ligj për të pasur një pasqyrë para shqyrtimit përfundimtar të këtij projektligji, një analizë të ligjit paraprak.

Pasi që nuk kishte diskutime të tjera, kryetarja ftoi deputetët për votim dhe konstatoi se komisioni, me 8 vota për, vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:

Rekomandim

Të miratohet në parim Projektligji nr. 08/L-011 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-061 për Shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore.

7. Shqyrtimi i përfshirjes së Ligjit për farërat në agjendën e komisionit për mbikëqyrjen e ligjit

Komisioni vendosi që edhe Ligji nr. 2003/5 për farërat, të përfshihet në planin e punës për mbikëqyrje.

8. Caktimi i ekspertëve dhe grupeve punuese për mbikëqyrjen e ligjeve

Kryetarja rikujtoi se në një nga mbledhjet e kaluara janë propozuar grupet punuese për monitorimin e ligjeve por ka mbetur që të plotësohen edhe me deputetë që nuk ishin prezent dhe të caktohet një kryesues i grupit. Më tutje Grupi punues do ta përgatitë planin e veprimit për mbikëqyrje, sipas të cilit do të realizojë vizita mbikëqyrës ne institucionet qendrore dhe lokale, si dhe ne terren dhe aktivitete të tjera deri në përfundimin e raportit me rekomandime i cili do të miratohet në Komision para se të dërgohet në seancë plenare. Pas propozimeve komisioni vendosi formimin e 4 grupeve të punës:

- Grupi i punës për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 2003/3 për Pyjet e Kosovës, në këtë përbërje: **Salih Zyba, kryesues**, Fadil Nura, Ekrem Mustafa, Samra Ilijazi dhe Fitore Pacolli-Dalipi – anëtarë;
- Grupi i punës për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës, në këtë përbërje: **Albena Reshitaj, kryesuese**, Milazim Salijaj dhe Fitore Pacolli-Dalipi – anëtarë;
- Grupi i punës për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 04/L-114 për pasurimin e miellit, në këtë përbërje: **Besian Mustafa, kryesues**, Bekim Haxhiu dhe Fitore Pacolli-Dalipi – anëtarë;
- Grupi i punës për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 2003/5 për farërat, në këtë përbërje: **Arbëreshë Kryeziu-Hyseni, kryesuese**, Salih Zyba – anëtar.

Bekim Haxhiu reagoi rreth faktit se një ligj monitorohet një vit apo dy pasi të filloi zbatimi d.m.th. jo paralel me projektligjin që ka të bëjë me atë ligj, d.m.th. gabim është ky monitorim.

Kryesuesja u përgjigj se nuk është gabim sepse monitorimi do të vërtetohet ku nuk është zbatuar ai ligj në praktikë dhe ku ka pasur probleme.

Salih Zyba u ndërlidh dhe arsyetoi monitorimin përkundër faktit se vjen Pl, ngase minitorimet në mandatet e kaluara nuk janë bërë si duhet ose nuk janë bërë dhe nuk ka raporte të tilla, përndryshe do të shikoheshin ato.

Ndërsa në lidhje me angazhimin e ekspertëve është kërkuar që t'i sjellin edhe propozimet për ekspertë, që do ta ndihmojnë këtë proces dhe pastaj të votohen në komision. Deri me sot nuk është dërguar asnjë propozim. Ndërsa kryetarja kishte tri propozime të eksperteve të cilat i shpërndau stafi anëtarëve të komisionit.

Salih Zyba kërkoi pak kohë për deklaram rreth ekspertëve sepse dikush nga komisioni mund të ketë sugjerime tjera d.m.th. pasurim të listës. Ai potencoi disa raste nga përvoja e mëhershme me ekspertë që tregojnë se duhet komisioni të krijojë në këtë drejtim një standard, jo vetëm përzgjedhje të një eksperti, ngase ndaj atij eksperti duhet të kemi besimin.

Kryetarja u pajtua dhe sugjeroi që të veprohet sipas rregullave dhe shtoi se ajo ka sjellë këto tri propozime dhe pret që do të vijnë ende nga komisioni, ngase deri sot nuk ka arritur asnjë propozim, por më së largu deri në mbledhjen e radhës ngase nuk kemi shumë kohë.

Salih Zyba: Sipas kësaj do të thotë se kemi drejt të propozojmë dhe sa mundemi të propozojmë, gjithashtu shprehu interesimin a duhet ndonjë filtër apo standard nga Kuvendi për të na mbetur neve në fund vetëm të votojmë.

Kryetarja tha se duhet të kemi parasysh që na duhen 4 ekspertë për 4 mbikëqyrje dhe i zgjedhim më të mirët, ndërsa administrata do t' i japë mbështetje komisionit rreth faktit të konfliktit të interesit.

Bekim Haxhiu: Bazuar në përvojat e deritanishme kur monitorimet zgjasin vetëm për një ligj së paku 4 muaj, sugjeroi që komisioni të fillojë me dy monitorime, ose 6 monitorime për vitin kalendarik. Ai shprehu gatishmërinë për me kontribua për ujëra dhe pasurimin e miellit, përkundër faktit që është angazhuar në një monitorim tjetër me një komision tjetër. Insistoi që të ketë komisioni kujdes nga konfliktet e interesit për të mos pasur ekspertiza joreale.

Albena Reshitaj shprehu gatishmërinë për me kontribuar për ujëra pasi ka qenë ish- ministre në MMPH dhe ka kaluar strategjinë e ujërave në Kuvend.

Arbëreshë Kryeziu-Hyseni sugjeroi të kontribuoi aty ku ka nevojë dhe sidomos të bëhen kombinimet e nevojshme në këtë drejtim pasi që duhet kryer punët që na presin.

Salih Zyba pyeti kryetaren pasi që ajo u deklarua që merr pjesë në secilin GP, a duhet të krijojë komisioni kontakte me te apo si, ndërsa kryetrja sqaroi se ajo është në secilin GP vetëm anëtare.

9. Të ndryshme

Rreth aktualiteteve në Deçan dhe helmimeve, kryetarja njoftoi se atje është çështja mjaft delikate dhe duhet analizat të bëhen, gjithashtu njoftoi se ajo në cilësinë e kryetares është ftuar sot në vizitë në Deçan nga Komisioni tjetër Parlamentar, ndërsa **Albena Reshitaj** shprehu interesimin të jetë pjesëmarrëse në atë vizitë.

Salih Zyba kërkoi mundësinë e informimit zyrtar nëse arrijnë ndonjë informatë e tillë.

Kryetarja premtoi se do të angazhohet në këtë drejtim për të informuar komisionin me zhvillimet më të reja, sidomos pas kthimit nga terreni.

Arbëreshë Kryeziu-Hyseni u pajtua se është gjendje alarmuese, prandaj apeloi për angazhim të këtij komisioni në çfardo veprimi dhe sipas nevojës.

Bekim Haxhiu u pajtua me reflektimin e anëtarëve të komisionit për këtë situatë në Deçan e cila ka indikacione se mund të jetë edhe epidemi virusal, ai mendoi se Komisioni për shëndetësi duhet të jetë pak më aktiv po qe se nuk ka helmim nga uji, duhet kujdesur për mos përhapjen e ndonjë virusi.

Mbledhja përfundoi në orën 11:30.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetarja e Komisionit,

Fitore Pacolli-Dalipi